



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 4113 Prot.

Tiranë, më 21. 11 2022

Lënda: Njoftim për caktimin e një përfaqësuesi, për të qenë i pranishëm në momentin e organizimit të shortit, për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Drejtuar: ZONJËS ERINDA BALLANCA
AVOKATI I POPULLIT

ZONJËS VITORE TUSHA
ANËTARE ME KOMPETENCA TË KRYETARIT TË GJYKATËS
KUSHTETUESE

ZONJËS NAUREDA LLAGAMI
KRYETAR I KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

ZOTIT ALFRED BALLA
KRYETAR I KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

Tiranë

Të nderuar,

Siç edhe mund të jeni në dijeni, pas njoftimit të bërë publik, Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 149/d, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 221, pika 7 – 10, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, ka vendosur të hedhë shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, ditën e hënë, **datë 5.12.2022, ora 10:00**, në sallën "Skënderbej", në selinë e Institucionit të Presidentit të Republikës, me adresë Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr.1, Tiranë.

Sa më sipër, në mbështetje të nenit 149/d, pika 3 të Kushtetutës, Institucioni i Presidentit të Republikës njofton zyrtarisht nëpërmjet kësaj shkrese Avokatin e Popullit, për të qenë i pranishëm si vëzhgues i të gjithë procedurës së hedhjes së shortit.

Gjithashtu njoftohen dhe ftohen, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të dërgojnë një përfaqësues, për të qenë i pranishëm përgjatë hedhjes së shortit. Sa më sipër, lutemi dërgimin e emrit të përfaqësuesit të institucionit tuaj, mosparaqitja e të cilëve nuk sjell pengesë për zhvillimin e hedhjes së shortit.

Në çdo rast, momenti i hedhjes së shortit do të ketë mbulimin e nevojshëm mediatik, si dhe janë marrë

masat që ky proces t'i nënshtrohet plotësisht parimeve të transparencës, gjurmueshmërisë dhe monitorimit, si edhe të bëhet e mundur ndjekja "live" dhe në kohë reale e procesit nga të gjithë institucionet, subjektet e interesuara dhe publiku.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Florian KALI

